

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BIG BLU POOL & SPA” Shpk

Sot më datë 06.02.2019, si themelues me te dhenat e mëposhtme:

- **Z. Ettore Bonacci**, qytetar italian, i lindur ne Livorno, i datëlindjes 02 Shkurt 1957, rezident në Itali, me Nr. Karte ID/Pashaporte YA6248643,
- **Z. Denis Rama**, qytetar shqiptar, i lindur ne Krujë, i datëlindjes 16 Tetor 1988, rezident në Tiranë, me Nr. Karte ID/Pashaporte I81016075D

Kane vendosur te nënshkuajnë Aktin e Themelimit te mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës regullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statusi i saj.

Neni 1- Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **“BIG BLU POOL & SPA” Shpk**

Neni 2- Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në: Paskuqan, Lagjja Paskuqan 1, Rruga Demokracia, ndertesa nr.1, Tirane
- 2.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do te bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 2.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 3- Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pacaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të shpërbëhet më përpara ose të zgjatet kohëzgjatja e saj me Vendim të Ortakëve.

Neni 4- Objekti i Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.
- 4.2 Shoqëria ka si objekt të saj projektimin, prodhimin, ndërtimin, shembjen, restaurimin, kontrollimin, manaxhimin dhe marketingun edhe përmes korrespondencës, për llogari të saj



ose palëve të treta, qoftë publike apo private të cdo forme juridike të : punimeve të plota, produkte, punime të destinuara për sektorë të tillë si : mekanikë, elektromekanikë, elektronikë, kimikë, bujqësi, mobilim, turizëm, ndërtim, trajtim ujour, ekologji, sport dhe produkte të tjera të lidhura me to ose plotësuese. Duke përfshirë gjithashtu edhe aktivitetet në vijim: konsulencë, projektim, ndërtim, shembje, prodhim, vendosje, restaurim, mirëmbajtje, zhvillim, menaxhim kontrolli, marketing, nisje dhe koordinim të iniciativave të reja në sektorin e ndërtimit, shërbime të organizura, përfshirë studimin, kerkimin, hulumtimin, realizimin e projekteve per llogari të të tretëve qofshin ente publike ashtu edhe private; të gjitha aktivitetet që lidhen me sektorët në vijim: ndërtim dhe restaurim të pishinave, objekte sportive dhe argëtuese, qendra te kujdesit personal, përfshirë objekte teknologjikë me ose pa pjesë; tregti (blerje, manaxhim, qira dhe shitje për palë të treta) dhe aktivite të përfaqësimit ose komisioneve për blerje të makinerive dhe objekteve. Shoqëria mund të marrë dhe të pranojë agjensi, komisione, perfaqësime e mandate, për të përmbushur të gjitha operacionet tregtare (përfshire dhe të import-eksportit), operacionet financiare nëse nuk janë në kundërshtim me interesin e publikut, duke përfshirë huazimet, paradhëniet dhe financim për palët e treta, veprime bankare, pasuri të tundshme dhe të patundshme nga të cilat, si dhe mund të marrë interesa dhe kuota të pjesëmarrjes në kompani të tjera ose ndërmarrje të cfarëdolloj natyre që kanë qëllime të ngjashme, analoge apo plotësuese të shoqërisë, vetëm nëse ato shërbejnë për arritjen e objektit të shoqërisë. Shoqëria mund të marrë ose japë me qira nga kompani të cilat kryejnë aktivitete të ngjashme. Gjithashtu shoqëria mund të ofrojë siguri dhe garanci, kryesisht në favor të palëve të treta, duke përjashtuar në cdo rast ushtrimin e kredisë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë për arritjen e qëllimeve të saj, shoqëria mund të marrë pjesë në një shoqëri tjetër ose ndërmarrje që kanë lidhje me njëra tjetrën, jo për qëllim vendosjeje, dhe mund të kryejë cdo veprimtari tregtare, të pasurive të patundshme dhe transaksione të letrave me vlerë brënda limiteve të parashikuara sipas ligjit, dhe financiare përsa kohë që nuk është e drejtuar drejt publikut.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar është 1,250,000 lekë (nje milion e dyqind e pesedhete mije), (ekuivalent me 10,000 Euro).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota , të gjitha të nënshkruara dhe per tu shlyer. Nje kuote me vlerë nominale 1,000,000 (nje milion) lekë e zoteruar nga z.Ettore Bonacci dhe nje kuote me vlerë nominale 250,000 (dyqind e pesedhete mije leke) e zoteruar nga z.Denis Rama..

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- **Z. Ettore Bonacci**, qytetar italian, ofron një kontribut në para të barabartë me 1,000,000 (nje milion) lekë.
- **Z. Denis Rama**, qytetar shqiptar, ofron një kontribut në para të barabartë me 250,000 (dyqind e pesedhete mije leke) lekë.



6.2 Sipas kontibuteve të mësipërme :

- Z. **Ettore Bonacci**, i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 80% (tetëdhjetë) të kapitalit të Shoqërisë me vlere totale 1,000,000 (nje milion) Leke
- Z. **Denis Rama**, i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 20% (njetetë) të kapitalit të Shoqërisë me vlere totale 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Leke

Neni 7 – Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.
- 7.2 Në rastin e transferimit të cdo lloj titulli, qoftë kundrejt një pagese apo jo në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra duke përfshirë dhurimin e aksioneve dhe personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, aksionet duhet të ofrohen me refuzimin e parë të Ortakëve të tjerë.
- 7.3 Në këtë rast ortaku shitës duhet tju komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë, me anë të një letre rekomanduese a/r ku të shprehet qartë, vullneti për të shitur aksionet, kushtet e shitjes përfshirë emrin e blerësit, emrin e shitësit, cmimin e shitjes. E drejta e parablerjes duhet ti referohet gjithsesi të gjitha kuotave të ofruara për shitje.
- 7.4 Anëtarët do të kenë 30 (tridhjetë) ditë kohë nga marrja e letrës a / r për të informuar aksionarin shitës për gatishmërinë e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Në rast të skadencës së afatit kohor, e drejta e parablerjes në favor të tyre do të bie poshtë.
- 7.5 Në rastin kur oferta pranohet nga shumica e Ortakëve, aksionet e shitura nga aksioneri ndahen në mënyrë proporcionale në bazë të aksioneve që zoterojnë secili prej tyre (pala blerese), nese nuk bëhet një marrëveshje ndryshe ndërmjet palëve. Në asnjë rast ofruesi nuk do të pranojë një ushtrim pjesor të së drejtës së parablerjes.
- 7.6 Në rast të dështimit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, aksionet mund të transferohen drejt palëve të treta në tërësi ose në pjesë.
- 7.7 Njësitë mund të transferohen me anë të trashëgimisë në raste fatkeqësie.

Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Shoqëria administrohet gjithashtu dhe nga një Administrator i cili qëndron në detyrë deri në shkarkimin ose dorëheqjen e tij, ose për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet.
- 8.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë do ti ngarkohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat në përputhje me dispozitat e nenit 95 të Ligjit nr. 9901 të datës 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".




- 8.3 Administratori mund të emerojë Prokurorë special për akte specifike ose kategori të ndryshme aktesh.
- 8.4 Adminisitrator i pare i shoqerise emerohet **Z. Denis Rama** lindur ne Kruje ne date 16 Tetor 1988, mbajtes i leternjoftimit/ pashaportes: **I81016075D**.

Neni 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe


ORTAKËT

Z. Ettore Bonacci



ETTORE BONACCI

Z. Denis Rama



Denis Rama